



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1018 Prot.

Tiranë, më 03.04.2024

VENDIM QARKULLUES

Nr. 44, datë 03.04.2024

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN QARKULLUES NR. 35, DATË 25.03.2024
“PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT DHE
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR
VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË” TË
SENATIT AKADEMIK TË UMT”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, Vendimit Qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit..." të Senatit Akademik, si dhe propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr. 1504/1 prot., datë 29.03.2024, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Pas pikës 4 të Vendimit Qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024, shtohet pika 4.1 si më poshtë:
 - 4.1. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (11 kuota) janë në mbështetje të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1504/1 prot., datë 29.03.2024, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Studenti transferohet nga programe specializimi afatgjatë, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Kandidati që kërkon të transferohet sipas kësaj pike, duhet të marrë miratimin paraprak nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për njohje dhe zbatim strukturave përkatëse.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA**

